



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1019/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Velić Zorica, kandidatë për anëtarë të kuvendit komunalë në Graçanicë, nga subjekti politik Samostalna Liberalna Stranka (SLS), paraqitur kundër Komisionit Qëndror Zgjedhor (KQZ), për shkak të publikimit të rezultateve përfundimtare për anëtarë të kuvendit komunal në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Velić Zorica kandidate për anëtarë të kuvendit komunalë në Graçanicë nga subjekti politik Samostalna Liberalna Stranka (SLS).

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 03.12.2013, nga Velić Zorica kandidate për anëtarë të kuvendit komunal nga SLS në Graçanicë, në të cilën pretendon se parashtronë ankesë lidhur me rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve lokale për komunën e Graçanicës, për asamble komunale, për asamble komunale, për qendrën e votimit 3408E dhe 3401E-05R. Mendoj se jam e dëmtuar me këto rezultate dhe kërkoj rinumërimin dhe kontrollimin e këtyre rezultateve.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

PZAP-i konstatoi nga shkresat e lëndës se pretendimet ankimore nuk qëndrojnë sepse parashtruesi i ankesës nuk ka ofruar asnjë provë dhe dëshmi bindëse që është bërë një shkelje e tillë, prandaj në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, si dhe neni 3.6 pika c) të Rregullores së PZAP-i lidhur me ankesën e lartë përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 1019/2013 më datën 06.12.2013

**Kryesuesi i Panelit
Ferit Osmani**



Këshillë Juridike: Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda 24(njëzetekatër) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.